



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2199 prot.

Tiranë, 2 . 2 . 2021

URDHËR

Nr. 24 , datë 2 . 2 . 2021

PËR

“MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES DHE PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE TË MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË PARA ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT 2021”

Në mbështetje të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 91 dhe 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, para zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021, si më poshtë:
2. Punonjësit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjatë periudhës zgjedhore, i krijohen kushtet e nevojshme dhe ju garantohet mosçënimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi.
3. Punonjësit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucionit të Ministrisë, i ndalohej çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
4. Punonjësi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucionit të Ministrisë, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo

zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

5. Gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i ndalohe të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat.

6. Punonjësi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka të drejtë të angazhohet si komisioner në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar zyrtarisht eprorin direkt dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore për këtë veprimtari. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

7. Nëpunësit civil të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjatë pjesëmarrjes në veprimtari, sipas pikës 4 të këtij urdhri, i ndalohe:

- a) të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor ose kandidat në zgjedhje;
- b) të manifestojë me pankarta, fletëpalosje ose me çdo mjet tjetër të shkruar dhe të ekspozuar publikisht;
- c) të jetë protagonist në aktivitetet/veprimtaritë politike ose të kandidatëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Sherbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Drejtorët e Përgjithshëm të Drejtorive të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmbush detyrat dhe është përgjegjëse për:

- a) kontrollin në mënyrë periodike të veprimtarisë së punonjësve të Ministrisë, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të Ministrisë, në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Për efekt të zbatimit të kësaj pike, kjo Drejtori publikon të dhënat e kontaktit në faqen zyrtare të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në veprimtari politike ose në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje;
- b) verifikimin e rasteve të denoncuar në faqen zyrtare ose nëpërmjet mënyrave të tjera, për përfshirjen e punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të institucioneve në varësi të saj, në aktivitete të ndaluara gjatë periudhës zgjedhore;
- c) njoftimin e punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë periudhës zgjedhore;
- ç) krijimin për vëzhguesit dhe shoqatat e regjistruara në KQZ, si vëzhgues të procesit zgjedhor, të aksesit të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për informimin e publikut dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të sipërcituar;
- d) marrjen e masave dhe realizimin e monitorimit të zbatimit të parashikimeve ligjore në fuqi për të garantuar mospërdorimin e:
 - i. veprimtarisë shtetërore ose funksionit për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;

- ii. zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucion ose realizimit të propagandës politike në to;
- iii. burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë elektorale e të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhorë, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- iv. detyruar, në fushatë zgjedhore, të administratës së Ministrisë brenda ose jashtë orarit të punës.

9. Sektori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe në institucionet e varësisë, merr të gjitha masat për monitorimin e sjelljes dhe veprimtarisë së punonjësve të Ministrisë gjatë periudhës zgjedhore, duke përfshirë:

- a) regjistrimin ditor në një regjistër të posaçëm të hyrjeve-daljeve në institucion të punonjësve të Ministrisë, destinacionin si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës të punonjësit;
- b) regjistrimin në regjistër, në orën 08.00, të të gjithë punonjësve që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin autorizohet lëvizja;
- c) verifikimin në vend të prezencës së stafit në punë gjatë orarit zyrtar, të paktën një herë në ditë. Kontrolli për prezencën në punë të punonjësve të Ministrisë, të materializohet me procesverbal, ku punonjësit prezentë në momentin e kontrollit, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale përbri emrit të tyre;
- ç) evidentimin e rasteve të mosparaqitjes në detyrë dhe të arsyeve përkatëse, apo respektimit të orarit zyrtar të punës;
- d) mbledhjen e raportimeve mbi raste konkrete të anagazhimit të punonjësve të Ministrisë në fushatën zgjedhore, në mbështetje të subjekteve zgjedhore apo kandidatëve në zgjedhje, në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- dh) në rast të konstatimit të shkeljeve nga punonjësi, dërgimin e rastit përkatës pranë eprorit direkt, me qëllim fillimin e ecurisë disiplinore kundër tij;
- e) dërgimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të raportit ditor mbi kontrollin dhe verifikimin e kryer për prezencën e punonjësve në punë gjatë orarit zyrtar së bashku me konstatimet përkatëse.

10. Drejtorët e Përgjithshëm të aparatit të Ministrisë dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detyrohen të marrin masat përkatëse për zbatimin e parashikimeve të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, si dhe të këtij urdhri dhe të raportojnë periodikisht në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.

11. Ngarkohen subjektet e këtij urdhri të kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë urdhër deri në datën 25 prill 2021.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA

